



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
BASHKIA GRAMSH
SEKTORI MZSH

Nr 845 Prot.

Gramsh 24.06.2025

Lënda: Informacion, mbi masat e marra nga sektori i MZSH-së për zjarret e mundshme gjatë e verës= vjeshtës për vitin 2025.

Drejtuar; Këshillit Bashkisë
Këtu

Sektori i Shrbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin për periudhen e vere-vjeshtës 2024, për mbrojtjen, parandalimin dhe shuarjen e zjarreve të mundshme në fondin pyjor e kullosor, në bashkëpunim dhe me Shërbimin Pyjor, Shërbimin pyjor të zonave të Mbrojtura, Drejtoreni e Bujqësisë, Drejtuesit e Njësive Administrative, Kryetarët e Fshatrave, banorët dhe përdoruesit e pyjeve e kulloteve, Ndërmarrjen e Ujësellësit dhe Komisariatin e Policisë Shtetit, ka hartuar këtë plan masash të miratuar nga Kryetari i Bashkisë.

PLAN MASASH

PËR MBROJTJEN, PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË FONDIN PYJORË DHE KULLOSORË TË BASHKISË GRAMSH

MBËSHTETJA LIGJORE

Ligji Nr.152, datë 21.12.2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", Ligjit Nr.139 date 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore".

Ligji 57. dt.30.04.2020 "Për Pyjet"

Ligj. Nr. 9693 dt.19.03.2007 'Për fondin kullosor' i ndryshuar'.

V.K.M Nr. 290 dt. 30.04.2004 " Për miratimin e strategjisë kombëtare dhe menaxhimin e zjarreve në pyje e kullota".

V.K.M nr. 1080 dt. 22.12.2010 "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësive vulnetare të shuarjes së zjarreve".

Shkresa nr.472 prot.dt.20.05.2025, Drejtoria e Pëgjithshme e MZSH-së, Ministria e Brendshme Tirane; "Mbi marrjen e masave për parandalimin dhe përballimin e situatave të zjarreve gjatë stinës së veres, në sipërfaqet pyjore dhe kullota"

VLERËSIMI I SITUATËS.

Duke u nisur nga situatat e viteve të mëparshme për rastet e zjarreve të rëna në pyje e kullota në periudhën e verës, në territorin e Bashkisë. Referuar zjarreve të rëna vihet re se muajt me risk të lartë për rënien e zjarrit përvèc muajve Korrik-Gusht, problematik dhe me një numër të madh zjarresh ka qenë dhe muaji Shtator, duke marrë shkas nga kjo situatë vlerësojmë se dhe për verën e këtij viti, mund të kemi një situate të vështirë me zjarre, për ti bërë ballë

situatave që mund të na paraqiten do të bëhet përforcimi i gadishmërisë me rreth 50% shtesë të efektivitet për çdo turn 24-orësh , i planizuar në librin e shërbimit dhe do të jetë në stacionin zjarrfikës, për muajt Korrik - Gusht - Shtator.

QËLLIMI

Eshtë parandalimi dhe marrja e masave për përballimi dhe shuarjen në një kohë sa me të shpejte e me efektivitet tē çdo rasti tē mundshëm zjarri që mund tē lindin në zonat pyjore dhe kullosore në territorin e Bashkisë për muajt e nxehëtë tē verës, si dhe sigurimi e ruajtja e gadishmërisë për zonën urbane.

PRIORITET

Shërbimi Zjarrfikës ka si prioritet inspektimin, parandalimin, shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njerëzve, gjësë së gjallë, pronës, pyjeve e kullotave etj, si dhe; mbajtja lartë tē gashmërisë së mjeteve, paisjeve dhe tē personelit zjarrfikës për tē qënë në cdo kohë tē gatshëm, për t'u përgjigjur cdo lloj situate që mund tē paraqitet. Gjatë këtyre muajve tē nxhehtë tē verës *vëmendje tē shtuar* do të ken masat parandaluese tē zjarreve në sipërfaqet pyje e kullota dhe shuarja në kohë e zjarreve që mund tē lindin.

PËRGJEGJËSIA DHE BASHKËPUNIMI

Sektori i MZSH-së në prioritet dhe përgjegjësine e sajë ka dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera. Ky bashkëpunim eshtë në vazhdimësi me, Drejtori i Shërbimit Pyjorë, Drejtori i Bujqësisë, Drejtori i Përgjithëshme tē MZSH-së, me Bashkitë fqinje për kordinimin e punës për ndërhyrjet e shuarjen e zjarreve në zonat e përbashkëta kufitare, si dhe me Komisarjatin e Policisë, për identifikimin dhe vënien para përgjegjësisë tē autorëve për zjarrvënie tē qëllimshme.

MASAT QË DO TË MERREN

Nr	MASAT ORGANIZATIVE	AFATI	ZBATUESI
1	Do tē marrë pjesë në takimet që do tē zhvillohen me Prefektin, dhe me drejtuesit e Emergjencave civile dhe tē Shërbimit Pyjor pranë Bashkisë, për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje e kullota.	Qershori Ne vazhdim	Shërbimi i MZSH-së
2	Do tē planizohen grafikët e shërbimit për përforcimin e gadishmerisë se mjeteve dhe rritjen e numurit tē personelit për këtë periudhë si dhe do tē ndërpriten lejet e zakonshme.	Korik Gusht Shtator	Shefi i MZSH-së
3	Do tē bashkëpunohet me Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve, përfurnizimin me uje tē mjeteve zjarrfikëse 24 orë pa ndërprerje, sipas situatave që do tē paraqiten.	Në vazhdimësi	Shërbimi i MZSH-së Ndërmarrja Ujësjellësit
4	Në tē gjitha Njësitë Administrative në vazhdimësi janë marrë dhe do te merren takime në bashkëpunim me; administratorët, inspektorët e shërbimit pyjor, kryepleqtë e fshatrave , komunitetin dhe grupet vullnetare,	Qershori Në vazhdimësi	Shërbimi i MZSH-së Shërbimi Pyjor Të gjithë pjesmarrësit

	do tē punohet pēr sistemet e lajmërimit dhe trajnimet e nevojshme të këtyre grupeve pēr shuarjene e zjarreve nē pyje e kullota,		
5	Automjetet zjarrfikëse, pompat thithëse, pompat e shpinës dhe paisjet e tjera do tē mbahen nē gadishmeri të plotë, duke kryer shërbimet e nevojshme.	Në vazhdimësi	Shefi i MZSH-së
6	Do tē bashkëpunohet me Komisarjatin e Policisë së Shtetit, pēr evidentimin e autorëve shkaktarë të zjarreve dhe vënia e tyre para përgjegjësive ligjore.	Në vazhdimësi	Shefi i MZSH-së Policia Shtetit
7	Do tē mbahen lidhje të vazhdushme me Kryetarin e Bashkisë, Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së, Komisariatin e Policisë, Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, pēr bashkëpunimin dhe kordinimin e veprimve pēr situatat e zjarreve nē pyje e kullota.	Në vazhdimësi	Në bashkëpunim
8	Do tē mbahen lidhje të vazhdueshme me specialistët e shërbimit pyjor pēr vleresimin saktë të situatës nē cdo rast zjarri nē pyje dhe mundësit e ndërhyrjes me automjetet zjarrfikëse.	Në vashdimësi	Shefi i MZSH-së, Drejtoria e Shërbimit Pyjor.
9	Do tē kordinohet puna me Kryetarin e Bashkisë, Drejtorinë e Përgjithëshme të MZSH-së, pēr cdo situatë zjarri masiv nē kufijtë e ndërsjellta me Bashkitë e tjera.	Në vashdimësi	Shefi i MZSH-së
10	Do tē mbahen kontakte e bashkëpunohet nē vazhdimësi pēr lajmerimin nga Kryetarët e Fshatrave dhe Administratorët pēr cdo rast.	Në vashdimësi	Shërbimi i MZSH-së Administratorët Krytar Fshati
11	Do tē organizohen takime me banorët e fshatrava, kryepleqtë, përdoruesit e kullotave, pēr tē sensibilizuar komunitetet pēr rrezikun e zjarrit, pasojat e tij si dhe penalitet pēr zjarrvenie të qëllimshme.	Në vashdimësi	Shefi i MZSH-së, Drejtoria e Shërbimit Pyjor
12	Pavarsisht situateve që do na paraqiten pēr zjarret nē pyje e kullota, nuk do cenohet gadishmëria e efektivit zjarrfikës nē zonën urbane.	E Përherershme	Shefi i MZSH-së



Adresa: Sheshi "Kamber Dermishi" Bulevardi "10 Koriku" Tel/Fax: 0513 2 2272 E-mail: bashkiagramsh@bashkiagramsh.gov.al